

Kompania Rajonale e Ujësjetës
Regional Water Supply Company

HIDROSISTEMI RADONIQI
S.H.A. - J.S.C.

Rruga "UÇK" 7 Gjakovë
Tel:+381 390 320 503
Fax:+381 390 320 997



PROTOKOLI

| | | | |
|----------|------------|------|------|
| Gjakovë | 21.05.2008 | Nr.: | 1401 |
| Rahovec | | | |
| Lumbardh | | | |

Projekti

3

hidroing. i dipl. Shpejtim Hadri
udhëh. për zhvillim dhe planifikim

13 faqe

AKTIVITETET MBI NGRITJEN E EFIKASITETIT MENAXHUES

Propozim / programi për investime
nga donatorë të mundshëm

**Plani për zvoglimin e
humbjeve dhe keqpërdorimeve**

PLANI ZHVILLIMOR I
KRU "RADONIQI"

Plani zhvillimor për zvoglimin e humbjeve të ujit- për KRU "Radoniqi"

- **Qëllimi**
- **Zgjidhjet e bartshme**
- **Përmbledhja e raportit të projektit**
- **Aktivitetet e projektit**
- **Përfitimet e projektit**
- **Synimi**
- **Përvetsimi i njohurive**
- **Aktivitetet e deri tashme**

Titulli i projektit: **Plani për zvoglimin e humbjeve dhe keqpërdoruesve**

Investitori: **KRU "Radoniqi", për rajonin jug-perëndimor të Kosovës**

Lokacioni: **Gjakovë, Kosovë**

Implementimi: **sa më shpejt i mundshëm Qershor 2008 – Qershor 2009**

Kushtshmëria: **€ 270.000**

Informacionet për kontakte:

Drejtuesi i projektit:

KRU "Radoniqi" Gjakovë – në kërkim të donatorëve të mundshëm

UCK Nr. 7

50000 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0)390 320 503

Fax: +381 (0)390 320 997

Kontakt personi: **z. Albert Zajmi, menaxher gjeneral**

E-mail: **albert_zajmi@yahoo.com**

Ekipi projektues:

Projektanti përgjegjës: **udh. sekt. planif. & zhvillim Z. Shpejtim Hadri, hidroinxhinier i dipl.**

E-mail: **r_shpejtimhadri@hotmail.com**

Qëllimi

Ofruesi i shërbimeve për prodhim dhe distribuim të ujit të pijshëm dhe grumbullim/largimin e ujrave të përdorura **KRU Radoniqi – SH.A.** për regjionin Gjakovë-Rahovec-Lumbardh, kërkon ndihmë financiare për përgatitjen e dokumentacionit dhe implementimin e projektit:

Plani për zvoglimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve të ujit.

Gjithashtu **KRU Radoniqi** kërkon ndihmë për identifikimin e institucioneve potenciale, financuese që do të kenë mundësi të financojnë në këtë program investiv.

Studimi në detaje i përgatitjes së projektit është marrë me punët teknike, financiare, juridike, socio-ekonomike ose institucionale, si dhe ndikimet mjedisore, e që janë në fazën përgatitore, por që kanë të bëjnë me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimin e ujrave të zeza, për qytetin/regjionin.

Ky **Projekt** do të jetë efektiv në programin investiv afatshkurtër (STIP) e që njëherit është edhe pjesë përbërse e planit zhvillimor afatgjatë.

Zgjidhjet e bartshme të praktikave më të mira

Projekti: Plani zhvillimor për zvoglimin e humbjeve të ujit- për KRU "Radoniqi" paraqet një hallkë mbajtëse në ngritjen e praktikave ekologjiksht më të mira. Përmes këtij plani, kemi planifikuar zvoglimin e humbjeve të ujit dhe përmirsimin e menaxhimit të resurseve ujore, mbi zgjidhjet dhe përvojat e bartshme për kompanin tonë.

Në vendë të përkushtimit për rindërtimin fizik të infrastrukturës ujore (e cila kërkon një investim kapital shumë më të madhë), përkushtimi i ekipit projektues përkrahë identifikimin dhe zvoglimin e humbjeve të ujit dhe keqpërdoruesëve në sistemin e ujësjellsit tonë, pra përmes përmirimit menaxhues të praktikave vepruese. Rezultati final i këtij projekti do të jetë zhvillimi i planit për redukimin e humbjeve të ujit, që planifikon të rezultoj me redukimin e humbjeve të ujit prej mesatarisht 1,6 mil. m³/vit, përgjat periudhës 5 vjeqare të projektit do të kurseheshin rreth 8 mil. m³ ujë.

Ky projekt për fazën e parë siguron një bazë për përvetsimin e praktikave më funksionale, metodologjive dhe udhëzimeve të dalura nga ky projekt për menaxhimin e përmiruar zhvillimor e ku më pas të barten edhe në njësit tjera të regjionit, pra në njësin e Rahovecit dhe të Lumëbardhit.

Përmbledhje e raportit të projektit

KRU “Radoniqi” menaxhon me prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm dhe sistemet e kanalizimeve aty ku ekzistojnë ato, të ndara në tre njësi të veçuara dhe gypin kryesorë me distribuimin e fshatrave. I gjithë sistemi mbulon me shërbime mbi 25.000 konsumatorë (mbi 230.000 banorë), përmes gypit kryesor $L=30.5\text{km}$ gjatësi dhe diametër nga $\text{Ø}1100\text{mm}$ deri $\text{Ø}500\text{mm}$ të ndërtuara më 1980, ndërsa në rrjetet shpërndarëse janë në përdorim edhe gypa kryesor rrugor të diametrave nga $\text{Ø}400\text{-Ø}100\text{mm}$ dhe $\text{Ø}80\text{-Ø}50\text{mm}$ gypa furnizues nga materiali AC të vjetëruar edhe deri mbi 40 vite, për të cilat nuk i’u është kushtuar shumë kujdes për investime në ruajtjen e tyre. Që nga ajo kohë, banimet janë rritur dhe bashkë me te edhe kërkesat për ujë. Menaxhimi jo efikas dhe mbipërdorimi i atëhershëm i resurseve ujore tani rezulton si më se i nevojshëm dhe më me ngarkesë për financimin e plan-projektit për redukimin të humbjeve me mjetet vetanake të KRU “Radoniqi”-t.

KRU “Radoniqi” është ballafaquar me një vëllim të madhë të humbjeve të ujit-keqëpërdorimeve. Humbjet e ujit dhe keqëpërdorimet janë definuar si ndryshimi ndërmjet ujit të futur në sistem dhe ujit të shitur. Humbjet e ujit dhe keqëpërdorimet përmbajnë dy komponente: humbjet fizike dhe ato komerciale. Humbjet fizike prezentohen si humbje nga rrjedhjet e gypave në sistemin distribuiv, nga kyqjet shtëpiake, dhe nga të gjitha rrjedhjet e sistemit. Humbjet komerciale prezentohen si sasia e ujit të harxhuar por e papaguar (nga kyqjet ilegale dhe pasaktësia e matsave). Si prioritet në implementimin e projektit është reduktimi i humbjeve + keqëpërdorimeve në sistem që tani një kohë të gjatë sillet 60-70% nga ujit i tërë i prodhuar.

Në vitin 2007 humbjet e ujit dhe keqëpërdorimet në sistemin e KRU “Radoniqi”-t, kanë qenë mbi 12 mil. m^3 ujë i pijshëm.

Zbatimet e projekteve financuese të më hershme nga KRU “Radoniqi” kanë qenë financiarisht të limituara për zbatimin e tyre, e që kanë ngec në fazat e studimit se si të gjenden zgjidhjet e kësaj problematike të humbjeve kaq të mëdha të ujit. Poashtu KRU “Radoniqi” nuk ka pas njohuri në kërkesat anësore të praktikave menaxhuese dhe se si t’u përkushtohet zbatimit të këtyre praktikave për zvoglimin e humbjeve, përderisa çdo ditë e më shumë rritej kërkesa për ujë dhe përkushtimi për ti plotësuar ato. Menaxhmenti i KRU “Radoniqi”-t, ka bërë përpjekje më të mëdha në rritjen e tejkaleshme të prodhimit me ndërhyrje në prodhimin e shtuar të resurseve ujore, se sa në eliminimin e shkaktarëve të humbjeve me vlera kaq larta.

Përmes këtij projekti, KRU “Radoniqi” kërkon që të formoj ekipin për menaxhimin dhe vlerësimin e shërbimeve për bashkëpunim dhe ndihmë nga ndonjë kompani e zhvilluar si konsulente në trajtimin dhe zvoglimin e humbjeve për zhvillimin dhe përmirsimin e praktikave menaxhuese të sistemit furnizues me ujë të pijshëm. Ekipi projektues do të zhvilloj degët kryesore (shtyllën) përmirësuese të strukturës organizative të ndërmarrjes sonë dhe praktikat operacionale duke përfshirë edhe grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre, përdorimi i tyre në softverë kompjuterik për monitorimin e furnizimit me ujë, përmirsimin e shërbimit të konsumatorëve dhe trajnimin për stafin e KRU “Radoniqi”-t.

Varësisht sipas rezultateve, ky projekt do të zhvillohet gjatë 5 vitet e planifikuara. Projekti planifikon të rris rezultatet me koston minimale në arritjen domethënëse në zvoglimin e humbjeve. Ky plan priret që të rezultoj me zvoglimin e 25-60%, gjithsesi me një çmim minimal të punimeve, me financim të rritur për fazën e implementimit por njëherit me zvoglim të nevojave për investime kapitale në të ardhmen. Me mbledhjen e këtij përfitimi mendohet që mbi 640.000m^3 ujë do të kurseheshin në vitin e parë të implementimit të projektit.

Aktivitetet e projektit

Qëllimi i këtij projekti është të ndërtoj kapacitete të ndërmarrjes për zvoglimin e humbjeve të ujit dhe zhvillimin e përmirsimit të praktikave menaxhuese të sistemit furnizues të ujësellsit. Aktivitetet e projektit përfshihen si në vijim:

1. Krijimi i një “task force” për zvoglimin e humbjeve të ujit

Veprimi-(et): Ekipi do filloj me krijimin e task forces për humbjet e ujit, të koordinoj dhe monitoroj implementimin e aktiviteteve të projektit. E menaxhuar nga drejtori teknik, task forca përfshir edhe konsultuesit nga partnerët lokal dhe anëtarët e stafit të ndërmarrjes sonë. Për planifikim të veprimeve sipas periudhave vijuese ata duhet të mbajnë takime javore mbi statusin e implementimit të projektit.

Rezultati-(et): **Krijimi i task forcës për zvoglimin e humbjeve të ujit**

2. Zhvillimi dhe përmirsimi i implementimit monitorues dhe zotërimin e fakteve

Veprimi-(et): Ekipi për implementimin e projektit i mbledhur për analizimin e të dhënave dhe informatave mbi strukturën organizacionale të ndërmarrjes, të karakteristikave teknike mbi sistemin e furnizimit me ujë, të prirur për matjen dhe të dhënat mbi procedurat zotruese, mënyrat e faturimeve dhe pagesave, humbjet e ujit të pamatur dhe humbjeve (përdorimeve) të paautorizuara (ilegale). Me përdorimin e këtyre informacioneve duke u bazuar në praktikën e deritashme menaxhuese dhe të gjendjes fizike të ndërmarrjes të vepohet për përmirsimet e të metave të identifikuar.

Rezultati-(et): **2.1) Formimi i listës së konsumatorëve nga pilot zonat e këtij projekti dhe informatat e specifikacioneve teknike mbi ujëmatsat dhe njehërit lokacioni i tyre; 2.2) Të dhënat kompatible mbi sistemin global të sistemit informativ të konsumatorëve (GIS); 2.3) Direktivat mbi vendëndodhjet e ujëmatsave, efektshmëria e matjeve të konsumit të ujit, leximi i matsave, identifikimi i humbjeve pa ujëmatsa dhe ata ilegal.**

3. Ngritja e menaxhimit të furnizimit me ujë dhe zvoglimi i humbjeve fizike

3.1 Mapimi

Veprimi-(et): Pilot zona, ku përfshihet me konsumator të kategorive të ndryshëm (amvisri, industri, lokale, ndërtesa kolektive e tj.) do të përzgjedhet për implementimin e projektit. Studimi gjeodezik i pilot zonës, nxjerrja e gjendjes momentale dhe skanimin e hartës së bërë dhe kodimin e saj. Në GIS duhet të barten të gjithë parametrat dhe karakteristikat teknike të rrjetit furnizues. Stafi i ndërmarrjes do të trajnohet për: të dhënat mbi vendodhjen e kyqjeve, përdorimin e specializuar të softverëve kompjuterik si ndihmë për skicimet dhe GIS-in (përdorimin e AutoCAD-it dhe AutoDesk Map), si të fusin të dhënat e objekteve në kartelën e GIS-it, e tj.

Rezultati-(et): **Digjitalizimi i hartave të pilot zonave për sistemet e ujësellsit dhe kanalizimit.**

3.2 Modelimi softverik i distribuimit me ujë

Veprimi-(et): Softweret e dedikuar, “WaterCAD”, të blera për modelimin dhe simulimin kompjuterik të punës së rrjetit furnizues. Softweri lejon analizim më të mirë të sistemit, përfshirë monitorimin e pjesëve të dobëta të rrjetit me një mundësi efikase të gjetjes së defekteve në atë rrjetë.

Rezultati-(et): **Modelimi softverik i blerë dhe i përshtatur për përcaktimin dhe lokalizimin e gjendjeve.**

3.3 Trajnimi i stafit të ndërmarrjes

Veprimi-(et): Përvetsimi më i madhë mbi strukturën organizative të ndërmarrjes i dizajnuar, dhe programi trajnues në mbështetje e kapacitetit të stafit për pozicionime të reja për zhvillimin e nevojshëm të paraqitur. Përmes projektit, stafi i ndërmarrjes do të trajnohet mbi të dhënat e kyqjeve (presionin, sasin e rrjedhjes, e tj.), analizimin e të dhënave dhe përdorimin e softwerëve enkas për këtë qëllim.

Rezultati-(et):

3.3.1) Një model për kalkulimet e humbjeve të ujit në rrjetë; 3.3.2) Udhëzimet për matjet në pilot zonat; 3.3.3) Të dhënat mbi ujëmatësat dhe riparimin sa më të shpejtë të rrjedhjeve; 3.3.4) Përforsimin e kapacitetit të stafit në mbledhjen e të dhënave dhe përdorimin e modeleve kompjuterike.

3.4 Matjet e zonave

Veprimi-(et): Rrjetet e pilot zonave do të rekonstruktohen për të mundësuar matjen totale të sasisë në hyrje të atyre zonave. Të gjithë konsumatorët e atyre zonave do të pajisen me ujëmatës. Konsumi i ujit do të matet përmes leximeve të rregullta të ujëmatësave. Në orët e natës fushata e lexim-matjeve do të drejtohet në përcaktimin e tri komponenteve nga minimumi i rrjedhjeve të natës (zero konsumi): 1. rrjedhjet në rrjetin kryesor publik; 2. rrjedhjet në kyqje; dhe 3. keqpërdorimet, uji i harxhuar i paautorizuar. Kampanja për matje gjithashtu do të përmirsoj edhe të dhënat e presioneve dhe sasive mbi kalibrimin e modelimit distribuiv të ujit.

Rezultati-(et): **Raporti mbi matjet zonale**

4. Zhvillimi i planit për zvoglimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve (2008-2013)

Veprimi-(et): Përfundimi i aktiviteteve të sipërpërmendura prej 1-3 e që do të përdoren mbi zhvillimin e planit për zvoglimin e humbjeve të ujit dhe keqpërdorimeve. Plani fikson edhe objektivat vjetore, qëllimet dhe veprimet për pesë vitet e ardhshme. Rekomandimet madhore dhe vijimet kohore të këtij plani janë përgjithsuar në Tab 1. si më mëposhtë.

| Aktivitetet | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|
| 1.Riorganizimi i ndërmarrjes dhe trajnimi i stafit | ■ | | | | |
| 2.Dokumenti i plotë mbi rrjetin në pikëpamjen e produktivitetit | ■ | ■ | | | |
| 3.Zhvillimi i të dhënave të hollsishme mbi konsumatorët | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ |
| 4.Implementimi i procedurave raportuese dhe analizuese mbi rrjedhjet në rrjetë | ■ | ■ | | | |
| 5.Identifikimi i të gjitha kyqjeve të konsumatorëve dhe matja e të gjithë atyre | ■ | ■ | | | |
| 6.Futja e leximeve të vazhdueshme të matsave i të gjitha furnizimeve zonale | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ |
| 7.Gjetja e zgjidhjes së problemeve të faturimeve paushalle | ■ | ■ | | | |
| 8.Instalimi i ujëmatsave kryesor dhe zonal | | | ■ | ■ | |
| 9.Futja e softwerit për faturim më të efektshëm dhe monitorim të hyrave nga to | ■ | | | | |
| 10.Instalimin e valvolave të mjaftueshme për veqimin e rrjetit në sistemin distribuiv | | | ■ | ■ | |
| 11.Auditimi vjetorë për administrimin e ujit | | ■ | ■ | ■ | ■ |

***Rezultati-(et):* Plani për zvoglimin e humbjeve të ujit dhe keqpërdorimeve përfshirë edhe fazat për implementim, rekomandimet për zvoglimin e humbjeve sipas llojeve të ndryshme, dhe një plan implementues dhe përfitimet nga aktivitetet e propozuara.**

Përfitimet nga projekti

Kapaciteti i arritshëm përfitues

Stafi i ndërmarrjes do të trajnohet me metodat nga më të ndryshmet si ato organizacionale, teknike dhe administrative për zvoglimin e humbjeve dhe keqëpërdorimeve të ujit të pijshëm dhe në përmirsimin e menaxhimit të tijë. Përmes takimeve me "task forcën", përfaqësuesit e qeverisjes lokale për arsyet e vetëdijsimit të nevojave për imlementimin e çmimoreve të arsyeshme për konsumatorët të cilët faturohen paushall, deri në eliminimin e paushallit për ato pilot zona. Kjo është hapi i parë skajshmërisht e rëndësishme për ndërmarrjen si dhe për komunën / rajonin e KRU "Radoniqi"-t, për aranzhimin e tarifave sa më reale të ujit. Konsumatorët, individualisht duhet të informohen përmes kompanisë për vlerën kushtuese të ujit dhe për rëndësinë e ruajtjes së resurseve ujore përmes kursimit të harmonishëm në konsumimin sa më racional të ujit. Një seriozitet në mirëkuptimin e çështjes së kursimit të ujit do të kishte pasojë shtrirjen e zgjeruar të të gjithë harxhuesëve përmes prezentimit të konkludimit gjithëpërfshirës të projektit.

Përfitimet mjedisore

Përfitimet mjedisore nga projekti do të nxierin nga zvoglimi i humbjeve të ujit, ku pason shpenzimi i zvogluar i ujit të trajtuar. Zvoglimi i humbjeve të ujit gjithashtu rezulton edhe me zvoglimin e ndotjeve të ambientit në recepietë siq janë lumenjtë ku ato shkarkohen. Paramendohet që uji i humbur/keqëpërdorur do të zvoglohet si total nga 800.000m³ ujë përgjat vitit të parë nga imlementimi i planit për zvoglimin e humbjeve të ujit dhe keqëpërdorimeve, dhe nga 15-20% nga uji i humbur (mesatarisht 2mil. m³ në vit) deri në fund të pesë vjeçarit.

Përfitimet ekonomike

Shumë përfitime ekonomike janë gjeneruar përmes imlementimit të projektit të rekomanduar. Kjo përfshinë:

- Uljen e shpenzimeve operative (si rezultat i zvoglimit i prodhimit të ujit) e vlerësuar mesatarisht në vlerë të € 3000/vit.
- Rritje e të hyrave nga shitja e ujit rreth 450.000 €/vit (si rezultat i rritjes së efikasitetit në zbulimin e harxhuesëve të cilët përfitojnë nga uji i pijes nga sezonat me thatësi si dhe matja e ujit të harxhuar për ata konsumatorë të faturuar paushall deri atëherë)
- Rritje e të hyrave përmes regjistrimit të kyqjeve ilegale dhe nga pasimi i matjes së tyre (tarifat për regjistrimin e konsumatorëve)
- Zvoglimi i nevojave për investime kapitale të nevojshme për 30.000 € /vit (përmes mënjanimëve të investimeve të pjesërishme në vlerë të 500 l/sec që janë nevoitur për rritjen e kapacitetit momental dhe 500 l/sec të parapara për fazën e II-të)

Kursimet mund të jenë edhe më të mëdha nga ky zvoglim po të ishte bërë (apo kur të bëhet) edhe trajtimi i ujrave të përdorura.

Përfitimet sociale do të përfshijnë edhe krijimin e 2 deri 4 vendeve të reja të punës në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët.

Synimi

Synimi kryesor i këtij plani është implementimi i programeve të projekteve STIP për përmirsimin e shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimeve të ndërmarrjes KRU “Radoniqi”-Regjioni jug-perëndimor i Kosovës, (Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardhi)

Faza 1 konsultative do të ofroj:

- (i) ndihmën themelore në vlerësimin e situatës me potencialin financiarë për të cilën do të mundë të bihej vendimi për financimin e STIP-it;
- (ii) plani i përmirimit të performancave financiare dhe operacionale të ndërmarrjes; dhe
- (iii) identifikimi i fondeve potenciale që do të mundë ndihmonin me financim

Përvetsimi i njohurive

- Auditimi i ujit do të zbatohet regullisht (çdo vit) për gjendjen fizike të infrastrukturës ujore në identifikimin e humbjeve të reja;
- Ujëmatje gjithëpërfshirëse që është e nevojshme për planin e menaxhimit total të ujrave;
- Auditimi i ujrave do të sigurojë të dhëna të përshtatshme për lehtësimin dhe minimizimin e kushtueshmërisë në implementimin e strategjive të selektuara dhe efektive për humbjet e ujit dhe keqpërdorimeve. Kjo do të përfshinte të dyja reduktimet nga ato humbje fizike të ujit përmes programit për detektimin e rrjedhjeve si dhe të reduktimit të humbjeve komerciale.

Aktivitetet e deritashme

Hyrje:

Në opinion mbizotron mendimi se resurset e ujit të pijshëm në sistemin tonë janë të bollshme dhe të parrjedhshme, dhe se nuk mund të vie deri te mungesa e ujit të pijshëm, se kemi akumulim të mjaftueshëm në liqe e tj.

E vërteta gjithsesi qëndron ndryshe, sepse “konsumi” i ujit të pijshëm është jo i njëtrajtshëm, krahasuar sipas zonave dhe nënzonave, e për këte në disa pjesë të qytetit ka ujë me bollëk kurse në pjesë tjera paraqitet mungesë, për ç’gjë ndërhyrjet në sistemin distribuiv janë të kushtueshme. Përveq problemit të harxhimit jo të njëtrajtshëm të ujit dhe mungesës së mjeteve financiare për përmirsimin e shërbimeve nga ndërmarrja jonë, paraqitet edhe problemi i humbjeve dhe përdorimeve ilegale të ujit, si dhe mungesa e instalimeve dhe paisjeve për monitorim, detektim dhe mirëmbajtjen e sistemit në nivelin e dëshiruar, përveq ndonjë përpjekjeje të dështuar të matjeve në kërkim të rrjetit të dëmtuar për sanimin e humbjeve të mëdha, e që për to pritet shumë gjatë, pra deri në dukjen e rrjedhjeve në sipërfaqe.

Rrjeti i ujësjellsit në qytetin e Gjakovës

Gjatësia e gypave primar në rrjetin e ujësjellsit të Gjakovës llogariten të jenë rreth cca 148 km, nga materiale dhe profile të ndryshëm. Në këtë rrjet ekzistojnë më se 170 valvola nga të cilët mezi sigurohet ndërrimi i lëvizjes dhe ndërprerja e ujit në disa pjesë të rrjetit, e kjo si pasojë e vjetërsisë, skadencës dhe për shkak manipulimeve të shpeshta, e të nevojshme për intervenime të defekteve në numër dhe përditshmëri.

Arsyetim

Arsyeja kryesore për kryerjen e matjeve hidraulike për vërtetimin e gjendjes aktuale të rrjetit, detektimin dhe rehabilitimin e tij është që furnizimi me ujë në të ardhmen të jetë sa më ekonomik dhe i mjaftueshëm për kohë më të gjatë duke përmirësuar shërbimet.

Në periudhën kohore nëntor-dhjetor 2005 është filluar me matje hidraulike sipas zonave, e më pas nëntor-dhjetor 2006 me detektimin për verifikimin e humbjeve të ujit.

Ndërmarrja jonë posedon me dizajnim hartash për rrjetin e ujësjellsit, në formën elektronike për pjesët e rrjetit (ortofoto), përderisa shumica e të dhënave janë nga kujtesa e punëtorëve më të vjetër e që është vërtetuar se nganjëherë rezultojnë me shumë josaktësi.

Ndarja e zonave sipas niveleve dhe vjetërsisë, për nxjerrjen e planit investiv

Ndarja e zonave është bazuar në karakteristikat e moshës së gypave, presionit dhe kategorisë së konsumatorëve.

Si zona më karakteristike janë:

1. Zona e rrjetit në pjesën e vjetër të qytetit ku thuhet se rrjeti ka mbi 50 vite
2. Zona e rrjetit në pjesët e ulta me presion të rritur
3. Zona e rrjetit në pjesët e larta me presion më të vogël

Ndarja e zonave sipas kategorizimeve në pjesëmarrje të konsumatorit:

1. Ndërtesa institucionale, objekte industriale, hoteliere dhe pompa karburantesh
2. Ekonomit e vogla-biznese tregtare
3. Objektet e mëdha banimi (banesa shumëkatshe dhe kolektive), dhe
4. Objektet individuale banimi

Për këto zona janë kryer matjet me metodën e bilansit dhe pastaj me konsumin e natës (zero-konsumin).

Matja e humbjeve është bërë me vendosjen e matsave kryesor me lexim nga baza, ku edhe janë vërtetuar harxhimet e natës. Me krahasimin e disa matjeve gjatë muajve tetor/nëntor 2006, hargjimët mesatare ditore, më të theksuara kanë rezultuar:

- Zona industriale ku përfshihet:
 1. Paralagjja “Kolonia”
 2. Fsh. Zidi i S. Agës
 3. Institucioni i TMK-së dhe policia e komunikacionit
 4. Fabrika
 5. Çerdhe e fëmijve
 6. Ekonomit e mesme dhe pompa e benz. në rr.Gjak.- Prizr.
 7. Lagje me banime individuale

- Zona e ulët pas urës së Tabakëve ku përfshihet:
 1. Brekoc
 2. Jahoc
 3. Meje
 4. Orize
 5. Pompa benzine
 6. Ekonomi të vogla mermerpunuesish
 7. Shtëpi banimi me oborre të punueshme

- Zona e epërme përgjat aksit rr.Gjak-Pejë dhe Sh.Polluzha, M.Camaj me:
 1. Banime idividuale me oborre të mëdha
 2. Institucione
 3. Objekte hoteliere
 4. Shtëpi të pabanuara
 5. Konsumator të paregjistruar dhe paushall
 6. Objekte në ndërtim

- Zona qendrore ku përfshihen banorët mes rrugëve rrethuese:
 1. UÇK, N.Tereza, Skenderbeu dhe Tirana
 2. Shtëpi individuale
 3. Objekte shkollore, hoteliere, stadioni, konviktet dhe ekonomi të vogla
 4. Banesa shumëkatshe
 5. Objekte institucionale e publike e tj.

Kriteriumet bazë për propozim sipas konsumit nga kosumatorët të kategorizuar për investime nga donator të mundshëm:

| Kategoria e konsumatorëve- | Hargjimi më i madhë |
|--|----------------------------|
| Institucionet, objektet industriale dhe hoteliere- | mbi 5 m ³ /ditë |
| Ekonomit e vogla- | mbi 3 m ³ /ditë |
| Banesat shumëkatshe- | mbi 170 l/ditë/banorë |
| Shtëpit individuale- | mbi 200 l/ditë/banorë |

Sipas këtyre kriterëve përfundimisht janë nxjerrur edhe zonat me humbje më të theksuar, sipas renditjes:

- Zonën e ulët pas urës së Tabakëve, me humbje 6,8 l/s që në përpjestim me hargjimet mesatare sipas leximeve varionin 11.14 l/s e që përbëjnë mbi 61%.
- Zona e epërme përgjat aksit rrugor Gjak.-Pejë me humbjet 3,77 l/s që në përpjestim me hargjimet mesatare sipas leximeve varionin 7,12 l/s e që përbëjnë mbi 53%.
- Zona nr.6 me matsin të mulliri i tejkalon 60%
- Zona 10 industriale të Trafo po ashtu tejkalon 60% e tj.

Si dhe me më rëndësi nënzona të pamatura për humbje por me intervenime të shpeshta në numër defektesh, pastaj nënzone strategjike (spitali i qytetit), dhe me vjetërsi të gypave të tejkaluara e që na nxisin për të parashikuar intervenimet për riparime dhe zgjerim të pjesëve të rrjetit.

Pra nga gjithë kjo është formuluar politika investive për ndërrimin e rrjetit, ndërrimin e valvolave dhe paisjet për të ardhmen me mjete dhe instrumente matëse monitoruese dhe detektuese.

Përfundim

Me vazhdimin e akcionit të matjeve dhe detektimit në rrjetin distribuiv të zonave do të krijohen kushte më të favorshme për funksionimin e fazes së parë të ballansit: prodhimi i ujit me hargjimin në destinacion të ujit, e jo rrjedhjes së tij pa u vërejtur. Prandaj për këtë shkak mendohet që paraprakisht të kërkohet financimi për praktikën menaxhuese për zvoglimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve e më pas të vërtetohen edhe masat se ku duhet të investohet në ndërrimin e rrjetave për arsye që do të zbulohen dhe vërtetohen.

Paramasa me paralogari janë gjithashtu pjesë e këtij projekt-programi

Ky projekt-program tashmë është investim nga Qeveria e Kosovës.